

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 273, dt. 13.12.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.12.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Rindërtimi i banesës zona kadastrale 8564, nr. pasurie 1/72, "Shtëpia e Flamurit", Korçë - Disa detajime dhe modifikime te projektit" si më poshtë:
 - Mbyllja e derës nga krahu verior dhe hapja e saj në atë jugor.
 - Detajimi i elementëve dekorativ në ballkonin në krahun verior.
 - Detajimi i elementëve të kornizave të gurit tek porta kryesore si dhe ato të kapiteleve.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI